UDHËZIM
Nr.1, datë 16.1.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR.11, DATË 5.12.2006 TË KQZ-SË "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 31 pika 1 germa "b", nenit 45 e vijues të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZON:

Neni 1

1. Pika 1 e nenit 3 ndryshon si më poshtë:

Anëtarët e KQV-së, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, emërohen nga KZQV-ja, me propozime nga partitë politike, si më poshtë:

- Një anëtar i propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë;
- Dy anëtarë të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Republikane Shqiptare;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Demokrate e Re;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Agrare Ambientaliste;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Demokristiane;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Demokracia Sociale;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Aleanca Demokratike;
- Anëtari i trembëdhjetë propozohet në gjysmën e KQV-ve nga Partia Demokratike e Shqipërisë, ndërsa në gjysmën tjetër nga Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 5 të këtij udhëzimi.

2. Pika 3 e nenit 3 ndryshon si më poshtë:

a) Në komisionet e qendrave të votimit, në të cilat anëtari i trembëdhjetë i përket Partisë Demokratike, KZQV-ja emëron kryetarin e KQV-së sipas propozimit të paraqitur nga kjo parti. Në këto komisione, KZQV-ja emëron zëvendëskryetar njërin nga anëtarët e propozuar nga Partia Socialiste sipas propozimit të paraqitur nga kjo parti.

b) Në komisionet e qendrave të votimit në të cilat anëtari i trembëdhjetë i përket Partisë Socialiste, KZQV-ja emëron kryetarin e KQV-së sipas propozimit të paraqitur nga kjo parti. Në këto komisione, KZQV-ja emëron zëvendëskryetar anëtarin e propozuar nga Partia Demokratike.

Neni 2

Në nenin 5, fjala "shtatë" bëhet "trembëdhjetë".

Neni 3

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.